



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3559/13 Prot.

Tiranë, më 21.12 .2023

V E N D I M

Nr. 84 datë 21.12 2023

**“PËR
LËVIZJEN PARALELE TË 1(NJË) PUNONJËSI, PERSONEL AKADEMIK NGA
DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT NË DEPARTAMENTIN E
AKTIVITETIT FIZIK , REKREACIONIT DHE TURIZIMIT PRANË FAKULTETIT
TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 49, në Statutin e UST-së neni 43, gërma II), në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, në Vendimin e Senatit nr. 06, datë 27.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, të ndryshuar, në shkresën e Dekanatit të FVFR me nr. 3475/1 prot., datë 18.12.2023 “Për kalimin paralel të Prof.Asc.Dr.Ferdinand Mara, pranë Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizimit në FVFR”, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 141 datë 19.12.2023 “Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 21.12.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë lëvizjen paralele të **Prof.Dr.Ferdinand Mara**, Dekan i FVFR, personel akademik në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit, kalon në strukturë në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizimit, pranë Fakultetit të Veprimtarisë dhe Shëndetit.
2. Miratimi i kësaj lëvizje nuk prek strukturën dhe organikën e njësisë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Njësitë kryesore, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Fakulteti i Veprimtarisë dhe Rekreacionit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR ÇOBANI

